



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr.10
Prishtinë, më 22.5.2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N - 303.

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali, kryetare, Biserka Kostiq, Rita Hajzeraj -
Beqaj, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyçi, Kymete Bajraktari dhe Justina Pula

Mungoi: Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri,
UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Ekrem Gashi, Osman Morina, Haki Kryeziu, banorë të fshatrave të
Kijevës, Komuna e Malishevës, Lejla Selimi, OSBE, Ervin Ibrahim, PDSPIUNDP,
Florije Kryeziu, UNICEF dhe Iliriana Orana.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 16 dhe 24 prill 2013;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për monitorimin e ligjit për barazi gjinore;
4. Diskutim lidhur me dëgjimin publik, për zbatimin e rekomandimeve për të drejtat e fëmijëve;
5. Shqyrtimi i disa peticioneve dhe kërkesave;
6. Të ndryshme.

Kryesuesja **Rita Hajzeraj**, tha se kryetarja e Komisionit vonohet pak dhe deri sa ajo të vjen, mbledhjen do ta udhëheq unë. Konstatoj se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e pestë të rendit të ditës, për arsye që të ftuarit në mbledhje mos të humbin kohë.

Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.

5. Shqyrtimi i disa peticioneve dhe kërkesave;

Rita Hajzeraj, tha se kemi disa kërkesa dhe peticione dhe për shqyrtimin e tyre, komisioni ka formuar grupin punues, ku pjesë e grupit jam edhe unë.

Ajo njoftoi Komisionin me petitionin e parashtruar nga banorët e fshatrave të rrethinës së Kijevës të Komunës së Malishevës, të cilët kanë shprehur pakënaqësitë e tyre, lidhur me ndryshimin e trasesë së rrugës. Ajo tha se afaristët e bizneseve dhe banorët e kësaj rrethine, kërkojnë që të mbetet, apo të rregullohet rruga e magjistrale së tanishme Mleqan-Kijevë, afaristët e bizneseve në këtë magjistrale, do të kenë një humbje të madhe, ku në bazë të konkludimeve, kemi konstatuar se këto biznese mbajnë gjalle së paku 10 mijë banorë të kësaj rrethine. Shtrohet pyetja, pse nuk rindërtohet rruga e tanishme në trasenë e vjetër. Kjo rrugë ka gjerësinë e duhur dhe kushton më lirë për Ministrinë e Infrastrukturës dhe për Buxhetin e Kosovës.

H.Kryeziu, banor i fshatrave të rrethinës së Kijevës, tha se ne jemi për një mbledhje me banorët e Kijevës, sepse nuk janë të gjithë banorët të pajtimit për ndërrimin e trasesë, përveç kryetarit dhe një numri shumë të vogël të banorëve, sepse edhe në dëgjimin publik janë ankuar, që nuk janë të pajtimit me këtë ndërrim, sepse po ikin edhe bizneset dhe çdo gjë kalon në anën tjetër të qytetit. Ai tha se me këtë ndërrim, po u bëhet një padrejtësi e madhe sepse është bërë një investim që nga vitet e 90-ta. Ne shtrojmë pyetjen, pse po devijohet rruga, kur ekziston gjerësia e duhur dhe i ka parametrat e nevojshëm për këtë. Ky është projekti i bërë në vitin 2011, por ai projekt është zhdukur dhe këtë e din vetëm Ministria.

Rita Hajzeraj, bëri pyetje, se a kanë pasur takim, apo a kanë dalë ministri apo zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës, apo të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor në terren, për ta marrë mendimin e bizneseve dhe të banorëve të asaj ane, dhe a keni hulumtuar (konsultuar) ligjin për shpronësim, se çka parasheh ligji.

H. Kryeziu, duke u përgjigjur në pyetjen e deputetes, tha se ministrja nuk ka dalë në terren për të marrë mendimet e bizneseve. Ligjin për shpronësim nuk e kemi hulumtuar. Kemi dërguar ankesë edhe në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, por ende nuk kemi asnjë përgjigje, që nga dërgimi i saj më 30 prill.

O. Morina, tha se banoret kanë bërë investime të mëdha individualisht në vlerë mbi 1 milion euro, me investime vetjake dhe kemi të punësuar mbi 40 persona. Ne nuk jemi kundër shtetit, por kundër njerëzve, që këto veprime i bëjnë për interesa personale. Janë

mbi 20 biznese, me së paku 6 punëtorë secili biznes, që marrin pagë prej ati vendi të punës dhe automatikisht, nëse largohet rruga nga aty, ne nuk kemi ku t'i marrim ato të ardhura.

E. Gashi, tha se nëse ndodhë devijimi i kësaj rruge, do të mbesin 500 punëtorë pa punë dhe me këtë problem nuk po merret askush, e madje as kryetari i Komune së Malishevës, e as Ministri i Transportit, i cili ka deklaruar se shpronësimet kushtojnë me lirë nëse devijohet rruga. Jemi në dijeni që njerëzit kanë blerë toka me çmim shumë të lirë për të bërë investime, sepse po bëhet devijimi i rrugës dhe ata do të jen përfituesit, e çka të bëjmë ne, për shkak të interesave të ngushta të disa personave.

Kryetarja, duke u ndërlidhur me parafolësin, bëri pyetje se a ka qenë prej fillimit ky plan i rrugës apo ka ndryshuar .

E.Gashi, tha se ky projekt është gjithkund nëpër rrugën që ka ekzistuar Prishtinë-Pejë, vetëm diku, 3 apo 4 kilometra, tani po donë me e anashkalua rrugën kryesore. Ne mendojmë se kjo nuk është e drejt, dhe se ata njerëz që kanë blerë prona dhe pretendojnë për të bërë ndryshimin e trasesë, neve po na bëjnë kërcënime.

Biserka Kostiq, tha se nuk po kupton se a bëjnë presion serbët apo kush.

E.Gashi, tha se nuk kanë kërcënim nga serbët, sepse ata i kanë shitur pronat, por kërcënimi vjen nga ata që i kanë blerë ato prona dhe që kanë përfitime, nëse bëhet ky ndryshim.

Kurtan Kajtazi, duke u ndërlidhur, tha se është edhe një peticion i banorëve të asaj ane, për ndryshim të trasesë, për shkak të viktimave që kanë pësuar viteve të fundit, dhe nuk pajtohet me atë që thuhet këtu, se institucionet nuk janë të përgjegjshme dhe nuk merren me këtë problem. Keni pasur debat publik me tri Ministri përgjegjëse për këtë, ne si Komision, ju kemi ftuar për t' ju dëgjuar rreth këtij problemi dhe më pas do të marrim vendim për këtë.

Kryetarja, tha se ne si Komision ju dëgjuam lidhur me problemet me të cilat po ballafaqoheni dhe se do të veprojmë në bazë të kompetencave dhe në përputhje me ligjin.

Kurtan Kajtazi, tha se ky peticion duhet të dërgohet në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për shqyrtim, që së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës, ta sqarojnë se ku është arsyeshmëria e ndërrimit të trasesë.

Rita Hajzeraj, tha se është mirë të bëhet një rekomandim për Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, sepse ai është kompetent për këtë gjë, por mund t'i dërgojmë rekomandim edhe Ministrisë së Infrastrukturës, që atyre banorëve t'ua sqarojnë, pse është bërë ky ndryshim i trasesë së rrugës.

Kryetarja, tha se tani si Komision kemi dy propozime; që të dërgojmë rekomandim për Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, dhe me një tjetër rekomandim, t'i drejtohem Ministrisë së Infrastrukturës.

Komisioni pasi dëgjoi banorët e fshatrave të rajonit të Kijevës, dhe pas debatit që u zhvillua rreth këtij peticioni, vendosi njëzëri që të bëjë këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni konstatoi se peticioni i përmbush kushtet formalo - juridike, për shqyrtim dhe i njëjti të dërgohet për shqyrtim në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.
- II. Komisioni kërkon nga Ministria e Infrastrukturës, që të sqarohet Komisioni për te drejtat e Njeriut si dhe parashtruesit e peticionit, pse është bërë ky ndryshim i trasesë së rrugës, dhe ku është interesi i shtetit në këtë rast.

Rita Hajzeraj, tha se kemi ankesën e qytetares nga Drenasi I. Orana, e cila është larguar nga puna në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ajo tha se në këtë ankesë theksohet se punësimi është bërë sipas marrëveshjes që kjo Ministri kishte me Agjencinë Evropiane të Mjedisit, dhe për këtë kemi ftuar vet I. Oranën, që të na njoftojë më në detaje për këtë çështje.

Komisioni pasi dëgjoi I.Oranën dhe kuptoj se ajo, për këtë largim nga puna ka ngritur padi në gjykatë, sugjeroi palën që të pres vendimin e gjykatës, sepse kjo lëndë nuk është kompetencë e Komisionit, pasi që ekziston pavarësia e pushteteve dhe çdo vendim i Komisionit për këtë lëndë, tani konsiderohet ndërhyrje në punët e gjyqësisë.

Kurtan Kajtazi, tha se kemi një kërkesë nga një banorë i fshatit Lluzhan i Komunës së Podujevës. Kërkesa ka të bëjë me dëmtimin e fushës rekreative sportive, që është dëmtuar nga reshjet e mëdha të borës, dhe kërkon që t'i dilet në ndihmë me mjete financiare, për rimëkëmbjen e objektit, fushës në fjalë.

Ai tha se kjo është një kërkesë e pakompletuar. Nuk ka sqaruar a ka leje ndërtimi, cili është plani. Nuk e ka dërguar as regjistrin e biznesit dhe dëshmitë e pagesave të taksave, dhe është mirë t'i kërkojmë këto dokumente shtesë nga ai. Pasi që ta kemi dokumentacioni e kompletuar, ne si Nënkomision për shqyrtim të kërkesave dhe peticioneve, do t'ia kthejmë përgjigjen, pa pasur nevojë të diskutojmë më në Komision.

Komisioni pas shqyrtimit të këtij peticioni, njëzëri vendosi që të nxjerr këtë:

Përfundim

Parashtruesi i kërkesës, z. A.E., duhet ta bëjë kompletimin e dokumentacionit, konkretisht të dërgohet plani i ndërtimit, leja e ndërtimit, regjistrimi i biznesit dhe a është pagues i rregullt i taksave.

Kurtan Kajtazi, tha se kemi edhe petitionin kundër ndryshimeve të historisë dhe ne si Komision, përveç se konstatojmë se si petition i përmbush kushtet formal- juridike, jemi që ky petition të dërgohet në Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, sepse ata janë kompetentë që të vendosin për këtë çështje.

Komisioni pas shqyrtimit të këtij peticioni, vendosi që të nxjerr këtë:

Përfundim

Komisioni konstaton se peticioni kundër ndryshimit të historisë, i përmbush kushtet formal- juridike, por nuk është kompetent për të vendosur, lidhur me këtë, prandaj, këtë petition e dërgon për shqyrtim në Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për monitorimin e Ligjit për barazi gjinore;

Kryetarja, njoftoi anëtarët e Komisionit se grupi punues për monitorimin e Ligjit për barazi gjinore, ka përfunduar punën sa i përket monitorimit të Ligjit për barazi gjinore, ka përgatitur raportin, por është kohë e shkurtër, sepse raporti është shpërndarë sot. Do ta shqyrtoni të gjithë dhe nëse keni diçka për të shtuar, bëni propozimet me shkrim dhe në mbledhjen e radhës do ta miratojmë.

4. Diskutim lidhur me dëgjimin publik për zbatimin e rekomandimeve për të drejtat e fëmijëve;

Kryetarja- tha se kemi pasur rekomandimet e miratuara në Kuvend për të drejtat e fëmijëve. Ne si Komision kemi mbajtur dëgjimin publik me ministrinë se sa janë zbatuar këto rekomandime. Shumica kanë ndërmarrë veprime lidhur me këto rekomandime, ndërsa Ministria e Shëndetësisë nuk është përgjigjur në ftesën tonë.

Ajo pyeti anëtarët e komisionit se a janë të pajtimit që në seancën plenare të vihet një pike e veçantë e rendit të ditës dhe të raportojmë lidhur me zbatimin e rekomandimeve të 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, që ta njoftojmë Kuvendin, me një raport se çka ka ndërmarrë Komisioni lidhur me këtë.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me propozimin e kryetares.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali